**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Nr.** 3134/2 **Prot.** **Pogradec më** 15 / 07 **/2021**

**VENDIM**

**Nr:** 66 **, datë** 14 / 07 **/2021**

**PËR KRIJIMIN E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore" neni 7, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma c si dhe nenit 25 të Rregullores së Këshillit të Bashkisë Pogradec me propozim të Kryesisë të Këshillit,

**VENDOSI:**

1. Krijimin e sekretariatit të Këshillit të Bashksië Pogradec me 2 anëtarë. (1 sekretari I Këshillit dhe një punonjës sekretariati.
2. Marrëdhëniet e punës për punonjësin e sekretariatit do të jënë në zbatim të Kodit të Punës. Përzgjedhja do të bëhet nga Burimet njerëzore në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit dhe Sekretaren e Këshillit.
3. Kriteret për përzgjedhjen e punonjësit të sekretariatit janë si më poshtë:
   3.1. Të jetë me arsim të lartë (niveli bachelor/master profesional)
   3.2. Të ketë përvojë pune
   3.3. Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
   3.4. ______________________.
4. Ky punonjës do të jetë brenda numrit total të punonjësve të miratuar nga Këshilli Bashkiak për vitin 2021.
5. Shpërblimi I punonjësit të sekretariatit do të jetë sipas katëgrosisë IV B, në referim të nivelit të pagave të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 36, datë 05.03.2020 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi" me ndryshime, tabela nr. 1.
6. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe anëtarët e Komisionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, Sekretariati I Këshillit dhe administrata e Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Sotiraq MANGËRI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku, Igj: nr. 2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, e-mail: bashkiapogradec@gmail.com